

**PROBLEME TË LËNA PEZULL:
VENDBANIMET E SHQIPTARËVE NË MESJETËN
E HERSHME**

1. Qerthulli tematik dhe diskutimi përkatës

Në këtë trajtesë kam bërë objekt diskutimi një temë të mirënjojohur e të shumëtrajtuar në studimet e derisotme mbi historinë e pashkruar të popullit shqiptar. Është fjala pikërisht për trevat e vendbanimeve shqiptare në periudhën e mesjetës së hershme, thënë më saktë: në kapërcyell të shek. V/VI e. j. deri në dhjetëvjeçarët e parë të shek. IX. Kufizimi i témës brenda këtyre caqeve kohore kushtëzohet kryekëput me dy drejtime të debatit shkencor përgjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar në arealin kulturor evropian, sidomos në atë gjermanishtfolës, ku koncepti i autoktonisë relative të popullit shqiptar në trojet e sotme të Ballkanin Perëndimor (dhe Qendror) sendërtohet ende në tri pamje:

a) si e pranueshme të paktën për periudhën prej fundit të antikitetit dhe e kufizuar në zanafillë në një zonë të Shqipërisë Veriore që përkon deri diku me trevën gjeografike të Matit;

b) si e përfthuar në një hapësirë gjeografike të Shqipërisë Veriore të quajtur dikur *Arbanon* (= shq. *Arbën* – më vonë edhe njësi politike-administrative: shek. XIII), shi në shpinë të Durrësit, ku gjetën strehë disa mijëra besimtarë të krishterë prej fisisit trakas të besëve, të cilët në dhjetëvjeçarët e parë të shek. IX e. j., më saktë në vitin 820, ishin të detyruar të linin trojet e tyre të dikurshme në masivin qendror të Rodopeve, pikërisht në zonën e Remesiana-s;

c) si e shtrirë në zanafillë pak a shumë në të gjithë hapësirën e sotme shqipfolëse, duke e ruajtur këtë pamje qysh prej periudhave të hershme të antikitetit;

Pjesëmarrja ime në këtë debat kufizohet në verifikimin e argumenteve pro dhe kundër tezës së parë dhe të dytë, që kanë si bartës kryesorë historianët gjermanë Georg Stadtmüller (1966²) dhe Gottfried Schramm (1981, 1994, 1999²). Lidhur me tezën e tretë (Ölberg 1995 7vv.), që mbështetet sot e gjithë ditën edhe në arealin kulturor-shkencor mbarëshqiptar¹, do të mjaftohem në përmbyllje të trajtesës me ndonjë

¹ Shih së fundi Sh. Demiraj 2006 *passim*.

vërejtje të skajshme të karakterit metodik lidhur me pozicionimin e entitetit etnik-gjuhësor shqiptar në qerthullin e entiteteve gjuhësore të (pa)njohura të Ballkanit në periudhën e antikitetit.

Lidhur me metodën e studimit më duhet të shtoj se, duke qenë gjuhëtar qasja ime ndaj një teme të kësaj natyre kushtëzohet në thelb me rrëthanën që çështje të historisë së gjuhës shqipe ngërthehen dashur pa dashur në spektrin e studimit të kulturës etnike të popullit shqiptar si bartës i kësaj gjuhe. Pra, në pikëpamje të metodës së studimit do t'i përbahem edhe në këtë rast orientimit gjuhësor-filologjik.

2. Premisa metodike

2.1. Areale kulturore-gjeografike ~ areale gjuhësore etnike

Mbështetur në perspektivën e studimit gjuhësor diakronik, nociioni "atdhe / vendbanime të shqiptarëve" në mesjetën e hershme mund të perceptohet fare mirë si një hapësirë kompakte gjuhësore në Gadishullin Ballkanik, që kufizohej dikur me areale të tjera ku nuk flitej shqip. Gjithashtu kjo hapësirë kompakte nuk përjashton aspak në tërësinë e saj bashkëjetesën midis gjuhëve të ndryshme, sikurse na dëshmojnë rrëthanat për pjesën tjetër të mesjetës deri në kohën e re – madje vise-vise edhe sot – në zona të tëra të Gadishullit. Dhe është fakt që në trevat e sotme kompakte shqipfolëse – të mirënjohura si *monada e Ballkanit* (Šufflay 1916 285) – janë folur e fliten edhe sot shumë gjuhë. Një rrëthanë të tillë gjuhësore nuk lejohemi të paktën ta përjashtojmë as për periudhën në fjalë (shek. V/VI – IX), aq më tepër që gjatë kësaj periudhe Ballkani i tërë u përball me fluksin e fuqishëm të fiseve sllave të jugut, të cilat, duke u përhapur e shtrirë gjithkund, i shtuan njëherësh një komponent të ri ekologjisë së marrëdhënieve ekzistuese ndëretnike e gjuhësore të Gadishullit.

Pra, në rast se e perceptojmë hapësirën gjuhësore shqipfolëse në periudhën e mesjetës në mënyrë opcionale si disagjuhëshe, në kuptimin e një zone ku bashkëjetonin disa grupime etnike-gjuhësore, thyejmë njëherësh një barrierë metodike që ka gëzuar gjithherë përkrahje në perëndim kryesisht në studimet e mirëfillta historike për Ballkanin, ku kufijtë kulturore-gjeografikë përcillen njëherësh si kufij etnikë-gjuhësorë. Rrjedhojë e këtij koncepti – për mendimin tim më se të diskutueshmë – janë p. sh. përfundimet e nxjerra gjatë hetimit të së ashtuquajturës Vija Jireček (= *Linie Jireček*), e cila përcillet nga shumëkush jo thjesht dhe vetëm si kufi i dy kulturave të qytetërimit evropian në mesjetën e hershme, por edhe si kufi ndarës i dy zonave gjuhësore-etnike të Ballkanit në fillimin të mesjetës, përkatësisht në një zonë *latine-romane* në Veri kundrejt gjegjëses *greko-bizantine* në Jug.

Më vonë, me dyndjen e fiseve sllave të jugut e gjithë kjo hapësirë – përpos ndonjë qendre urbane bregdetare të fortifikuar – mendohet të ketë qenë rrafshuar tërësisht në pikëpamje gjuhësore etnike. Në vijim të kësaj hullie syzimi, rrëgjimit etnik-gjuhësor duhet t'i kenë shpëtuar vetëm disa zona të vështira malore në Ballkanin Qendror dhe/ose Perëndimor, e pikërisht aty mundën të ruanin e mbronin identitetin e tyre dy gjuhë të mëhershme ballkanike: shqipja dhe rumanishtja e përbashkët. Kjo përsiatje e marrëdhënieve gjuhësore-etnike në Ballkan përgjatë mesjetës së hershme mendoj se është e gabuar, dhe nuk i përgjigjet realitetit të kohës, për të cilën po diskutojmë.

2.2. Ndikimi i greqishtes së vjetër si barrierë psikologjike

Kufizimi i hulumtimit në hapësirën kohore midis shek. V/VII deri IX e çliron historianin e gjuhës nga një barrierë e fortë psikologjike, meqë çështja e vendbanimeve të shqiptarëve në Ballkan është ndëriksur gjithherë me shkallën e ndikimit të greqishtes së vjetër ndaj shqipes, duke u ndërvarur prej tij. Në rastin tonë, kufizimi i gjurmimit të vendbanimeve të shqiptarëve në periudhën e mesjetës së hershme e mënjanon këtë problem, që mbetet përfatësia e këq ende i pazgjidhur në albanologji.

2.3. Marrëdhëniet e filacionit së shqipes me një gjuhë të Ballkanit antik

Duke e kufizuar hetimin e hapësirës shqipfolëse në mesjetën e hershme, ne gjëzojmë edhe një tjetër përparësi në hulumtim, pasi çlirohem i nga barra e rëndë që i kemi vënë vetes deri sot përfshirë gjetur dhe saktësuar marrëdhëniet e filacionit të shqipes me njëren ndër gjuhët që fliteshin dikur në Ballkanit antik. Nisur nga këndvështrimi i mirëfilltë gjuhësor kemi të bëjmë këtu – thënë troc! – me gjuhë fantazma, të cilat në çdo rasë e nevojë ndryshojnë emër dhe formë. Mbështetësit e tezës së autoktonisë së shqiptarëve në trojet e sotme e identifikojnë këtë gjuhë në kohën tonë me të ashtuquajturën ilirishte ose degëzime të saj, si p.sh. epirotishtja apo dardanishtja etj. Në Perëndim nuk mungojnë gjithashtu as kundërshtarë të kësaj teze, të cilët mëtojnë marrëdhëniet filacioni me gjuhë të tjera rrënoja, që duhet të janë folur dikur në lindje të Ballkanit antik, të tillë si trakishtja ose degëzime e saj si dako-mizishtja, besishtja etj. Të gjitha këto teza e supozime i bashkon në vetvete një emëruesh metodik i përbashkët: operojnë me gjuhë imagjinare – thënë më saktë pseudogjuhë – meqë ato nuk na ofrojnë gjë tjetër përpos ndonjë glose të rrallë e të dyshimtë si edhe një burie njësisht toponomastike, më se të vështira përfshirë t'i interpretuar në pikëpamje etimologjike.

Meqë kjo trajtesë nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me marrëdhëniet të kësaj natyre, po mjaftohem të theksoj këtu mendimin tim, që kërkimet në paleoetnologjinë e Gadishullit Ballkanik vështirë se do të jenë dikur në gjendje të verifikojnë apo të falsifikojnë marrëdhëniet e filacionit të shqipes me një gjuhë rrënojë të Ballkanit antik, sa kohë që nuk kemi në dispozicion një tekst sado të shkurtër prej asaj gjuhe.

2.4. Rruga e tretë

Dalja nga ky rrëth vicioz, ku është futur dashur pa dashur gjurmimi diakronik i shqipes dhe i kulturës etnike të bartësve të saj, lejon si zgjidhje alternative një të ashtuquajtur rrugë të tretë. Lejohem të citoj me këtë rast mendimin e një kolosi në historinë e albanologjisë dhe të indoевropianistikës, gjuhëtarit danez Holger Pedersen, i cili duke shqyrtuar etnonimin e dikurshëm të shqiptarëve kumton, si vijon:

“Është pra e qartë, që në emrin etnik të shqiptarëve, pa marrë parasysh gr. Ἀλβανοί dhe emërtimin [me shformim] sllav që sipas Meyer-it fshihet në emrin e trevës *Labëri*, duhet caktuar [si parësore forma me] *r* (jo *l*). Grekët e kanë riformësuar emrin sipas një asociacioni të paqartë me emra të tjera gjeografikë. Se ç’do të thotë *arbən-*, kjo është natyrisht e vështirë për t’u sqaruar. Në rast se do të ishte identik me gr. ὄρφανός (pra në zanafilë emërtim i një fisi migrator), kjo do të ngërthente në vetvete një profeci të fatit të [këtij] populli.”²

Ky qëndrim, për mendimin tim, mundëson të paktën një ridimensionim të metodës dhe të qëllimit të kërkimit, përkatësisht të verifikimit të vendbaneve të hershme të shqiptarëve, duke u mbështetur kryekëput në hetimin e historisë së brendshme e të jashtme të shqipes e në bashkëlidhje me të me përpunimin e të dhënave që përfitojmë prej gjeografisë historike gjuhësore të trevave të sotme shqipfolëse.

3. Ndarja dialektore e hapësirës kompakte shqipfolëse në shek. V/VI – IX e.j.

Në vijim të kësaj metodike pune nuk e kemi të vështirë për të deduktuar me saktësi që sistemi gjuhësor i shqipes qysh në fazën e parë të mesjetës së hershme nuk sillej më i njësuar në gjithë hapësirën kompakte ku flitej shqipja atëbotë. Një ndër tronditjet e para të sistemit

² Citati original: „Es ist also klar, dass der eigene name der Albanesen, ohne rücksicht auf gr. *Ἀλβανοί* und die im gaunamen *l'abəri* nach Meyer steckende slavische bezeichnung, nur mit *r* (nicht *l*) angesetzt werden darf. Die Griechen haben den namen nach unklarer association mit anderen geographischen namen umgestaltet. Was *arbən-* bedeutet, ist natürlich schwer zu sagen. Sollte es mit gr. ὄρφανός identisch sein (also ursprünglich bezeichnung eines ausgewanderten stammes), würde es so zu sagen eine prophezeiung vom schicksal des volkes enthalten.“ (Pedersen: *Die albanesischen l-Laute*, KZ 33 [1895] 551)

arrijmë ta izolojmë p.sh. me dukurinë e rotacizmit të bashkëtingëllorës hundore /n/, që u përf tua në zanafilë në një mjesë rrethues zanor, dhe përfshiu si i tillë vetëm një pjesë të hapësirës kompakte shqipfolëse, bash atë që e quajmë sot toskërishte: */n/↓t. /r/ | V_V.

Rezultatet e hulumtimit diakronik dëshmojnë gjithashtu bindshëm që kjo dukuri dialektore e shqipes ka përfshirë krahas fondit të burimit indoevropian edhe shtresat e huazimeve leksikore nga gregishtja e vjetër dhe latinishtja, khs.: t. *llérë* = g. *llānē* < pshq. */*Vlenā* / : gr. ὠλένη; g. *mokēn* = t. *mokér* < gr. dor. μάχανά; g. *lakēn* ~ t. *lakér* < gr. λάχανον; g. *rānē* ~ t. *rērē* < lat. *arēna* etj. Përkundrazi, gjurmët e veprimit të saj në shtresën e huazimeve sllave të shqipes janë, në mos të diskutueshme, të paktën të papërfillshme, khs.: t. *tērésirē* „litar“ < bulg. търстина „litar i sajuar me lesh dhie“³ Këto rrethana kanë bërë të mundur edhe izolimin në kohë të kësaj dukurie, e cila pranohet sot gjithkund e prej gjithkujt në albanologji se ka pushuar së vepruari, të paktën në periudhën e intensifikimit të marrëdhënieve të ndërsjella shqiptare-sllave, periudhë që shkon deri aty nga shek. VIII-IX e. j.

Kjo rrethanë na jep tash dorë të orientohemi drejt në qerthullin problemor që parakupton tema komplekse e hetimit të trevave shqipfolëse në periudhën e mesjetës së hershme. Të paktën në një pikë jemi të qartë: ndarja dialektore e arealit të dikurshëm gjuhësor shqipfolës i bie ndesh tezës së migracionit të shqiptarëve në hinterlandin e Durrësit në dhjetëvjeçarët e parë të shek. IX e. j. (§ 1b) Kritika që mund t'i bëhet kësaj teze është shumëplanëshe, por mund të mjaftohemi këtu me vërejtjen, që dasia dialektore e një hapësire gjuhësore zakonisht është produkt i një numri dukurish gjuhësore me kohëzgjatje të konsiderueshme e që parakupton një numër bukur të madh folësish natyrorë, përkatësisht një hapësirë shumë më të shtrirë gjuhësore me një ose disa vatra rrezatuese.

3.1. Jugu i Shqipërisë – pjesë përbërëse e hapësirës kompakte shqipfolëse në mesjetën e hershme

Kjo situatë gjuhësore, d.m.th. çarja dialektore e sistemit gjuhësor të shqipes në kohë dhe hapësirë, rrezikon pas gjase të shkaktojë kolizion edhe me përsiatjet e grupimit të atyre historianëve që e kërkojnë “atdheun” e shqiptarëve në mesjetën e hershme pikërisht në trevat e sotme të hapësirës shqipfolëse, duke e rrudhur atë në krahinën e quajtur dikur Arbanon, ose të paktën në një pjesë të saj, p.sh. në trevat e Matit (§ 1a). Nisur nga kjo rrethanë, shumëkush lejohet të njohë të paktën si zgjidhje alternative marrjen në analizë edhe të hapësirës gjeografike gjuhësore të Jugut. Sigurisht që bëhet fjalë këtu për praninë

³ Shih së fundi Svane 1992 292; Ylli 1997 261, 316vv.

e një entiteti gjuhësor etnik, i cili për periudhën në shqyrtim gjëllinte në këtë territor së bashku me bashkësi të tjera gjuhësore-etnike, si p.sh. ato greke, (më vonë) sllave dhe – pse jo – edhe ato romane/arumune.

Ndër argumentet gjuhësore që u bien ndesh përgjithësisht përfundimeve të grupimit në fjalë lejohem të përcjell në debat:

a) Ndjekimi i greqishtes së mesme, përkatësisht i kulturës greke-bizantine në mesjetën e hershme ndaj shqipes nuk mund të nënvliftësohet aspak. Kështu p.sh., mjafton të përmendim këtu huazimin t. *korë* “ikonë” < gr. (εἰ)κόνα me dukurinë dialektore të rotacizmit, i cili na lejon të përsiasim që popullsia e krishterë në jug të hapësirës kompakte shqipfolëse mund dhe duhet të ketë përcjellë të ashtuquajturën “luftë të ikonave” midis Kishës së Lindjes dhe asaj të Perëndimit (shek. VIII-IX)⁴.

b) Me të njëjtën rrethanë përballemi edhe gjatë hetimit të makrotoponimeve antike, si p.sh. emri i qytetit antik të *Vlorës* që buron në instancë të fundit prej gr. Αὐλών ~ (kall.) Αὐλῶνα (Jireček IAF I 1916 177), e që shumëkush – në sajë të një metateze të mundshme të përfthuar në rrokjen nistore – rreket ta përcjellë në shqipe me ndërmjetësimin e sllavishtes së jugut (Weigand 1927 239; Schramm 1981, 391f.). A gjen mbështetje ky mëtim me të dhënët e sotme të albanologjisë dhe të sllavistikës? Kjo çështje lë shteg për shumë diskutime. Për momentin paraqet më shumë rëndësi fakti që ky toponim i është nënshtuar në shqipe dukurisë së rotacizmit, e cila siç përmendëm më lart ka vepruar në shqipe në shek. VI – IX e. j. Përsiatja e një riformimi të mëvonshëm analogjik mbetet në këtë rast e pambështetur dhe duhet përjashtuar patjetër, në qoftë se marrim parasysh edhe faktin që në gjithë zonën përreth sikurse në gjithë Jugun e hapësirës kompakte shqipfolëse mungon një model i mundshëm. Përkundrazi, në Juglindje të qytetit të *Vlorës* ngrihet kalaja e *Kaninës*. Emri i saj nuk dëshmon asnje shfaqe të dukurisë dialektore të rotacizmit, e kjo për një arsy me se të thjeshtë: kjo qendër e fortifikuar dëshmohet me këtë emër prej fillimeve të shek. XI⁵, d.m.th. në një periudhë kur kishte pushuar me kohë së vepruari dukuria në fjalë.

c) Pa dyshim që një sasi e konsiderueshme e toponimeve dhe hidronimeve në Jug të Shqipërisë është e burimit sllav, përkatësisht format e përdorimit të tyre në shqipe mund të shpjegohen thjesht dhe vetëm nëpërmjet ndërmjetësimit të sllavishtes, si p.sh. *Vjosë*, *Osum*, *Seman*, *Korçë* etj. Gjithsesi kjo rrethanë nuk parakupton aspak që në Jug të hapësirës së sotme kompakte shqipfolëse flitej vetëm sllavisht

4 Shih më hollësishët Demiraj 2001/2002 34.

5 Shih Acta et Diplomata I Nr. 58 (1019: τὰ Κάνινα).

(dhe – më parë – greqisht). Një pasqyrë të gjendjes multietnike të kësaj zone mund të fitojmë edhe me hartën toponomastike të gjithë zonës në shek. XV-XVI, ku emrat e vendbanimeve me origjinë sllave variojnë në kuotat 25% në Jugperëndim (Palasë) dhe 62% në Juglindje (Skrapar)⁶, ndërkojë që shpërndarja dialektore e huazimeve leksikore sllave varion ndërmjet 430 (Korçë) dhe 186 (Sarandë) njësi⁷.

d) Edhe një fakt nga historia e jashtme e shqipes e tumir mendimin për praninë e vendbanimeve shqiptare gjatë mesjetës së hershme në jug të hapësirës së sotme kompakte shqipfolëse. Është fjala për konkordancat midis shqipes dhe rumanishtes, të cilat shfaqen në të gjitha nivelet dhe në një numër shumë më të madh në toskërishte në përqasje gegërishten.

3.2. Veriu i Shqipërisë – pjesë përbërëse e hapësirës kompakte shqipfolëse në mesjetën e hershme

A flitej shqip në mesjetën e hershme edhe në pjesën veriore të hapësirës së sotme shqipfolëse? Kjo pyetje merr ndërmjetshëm përgjigje pozitive në rast se i referohemi rishtas dukurisë dialektore të rotacizmit në shqipe, e cila nuk e ka ngërthyer këtë zonë gjatë veprimit të saj. Për më tepër edhe hetimi i fondit të makrotoponimeve ekzistuese mbështet bindshëm mendimin që ky fond në shumicën e tij dërrmuese shpjegohet gjuhësisht pa marrë parasysh një ndërmjetësim të mundshëm të formave sllave.

a) Të tilla janë p.sh. makrotoponime si *Drisht* : lat. *Drivastum* (= /drívastu-/), *Ulqin* : gr. Όυλκίνιον, lat. *Olchinium* (= */ulkín-/) ose *Shkodër* : gr. Σκόδρα, lat. *Scodra* (= /skódra/), apo hidronime të tipit *Ishm* : lat. *Issamus* (= */ísamnu-/). Në këtë qerthull bën pjesë edhe toponimi *Durrës* (: gr. Δύρραχιον, lat. *Dyrrachium*), të cilin Weigand-i (1927 239) e pas tij edhe Schramm-i (1994 27.v.) përpilen ta shpjegojnë me ndërmjetësinë e një forme sll. * *Dvrvāč* (khs. serb. *Drâč*). Ky shpjegim kundërshtohet së fundi me të drejtë nga Matzinger (2009 94), i cili rindërton për shqipen një formë ndërmjetëse romane */dúrratso/ me bashkëtingëllore afrikate /-ts-/ dhe theks nistor indigen, duke pranuar si kufi të kalimit të saj në protoshqipe shek. V e.j. Pa dashur të hyjmë më shumë në hollësi lidhur me atë interpretim, mund të vëmë në dukje se ky cak kohor për toponimin në fjalë, qoftë edhe ante quem non, i përshtatet më së miri përsiatjeve tona mbi vendbanimet shqiptarëve në perëndim të Ballkanit gjatë mesjetës së hershme⁸.

⁶ Ylli 2000 199.

⁷ Ylli 1997 298.

⁸ Gjithashu duhet mbajtur parasysh që një formë me bashkëtingëllore afrikate në trup të fjalës na dëshmohet qysh në shek. III e.j., khs.: <Dyrratio> (Tab. Peutingeriana, sect. VI)

b) Sigurisht që me fluksin e fiseve sllave të jugut në Ballkan edhe në këtë zonë pritej të ndodhnin përzierje të marrëdhënieve gjuhësore-ethnike, ashtu siç i përcjellim pjesërisht a) në statistikat e fondit toponomastik të shek. XV-XVI, ku toponimet me burim sllav lëkunden ndërmjet 79% në lindje (Dulgoberda), 14% në perëndim (Malet e Mjet) dhe 5% në trevat e Matit (Fandi)⁹; si edhe b) në përhapjen dialektore të huazimeve sllave që variojnë midis 402 (Shkodër) dhe 185 (Mati) njësi leksikore¹⁰.

3.3. Krahina e Matit si zonë relikte e shqiptarëve në mesjetën e hershme

Ky regjistrim empirik i të dhënave toponomastike dhe leksikore dëshmon bindshëm që elementi sllav është thuajse i papërfillshëm në krahinën e Matit, të cilën historiani gjerman Georg Stadtmüller (1942; 1966² 118ff.) e syzon si një zonë relikte për bashkësinë shqipfolëse në periudhën e mesjetës së hershme. Shumë studiues i janë bashkuar ndërkohë kësaj teze, edhe pse dikush e sheh këtë paksa të ngushtë e ndonjë tjetër përsiat më shumë se një të tillë.

a) Pa dashur të pjesëmarr drejtëpërdrejt në diskutim lidhur me shtrirjen gjeografike të kësaj zone në mesjetën e hershme, po lejohem këtu të përmend se vetë emri i lumit të Matit, që dëshmohet me këtë emër ndoshta jo rastësish në shek. IV/V e. j. (Vibius Sequester), pra në fund të antikitetit, është pas gjithë gjasash i burimit shqip. Këtë mendim e forcon përdorimi i tij në shqipe edhe si apelativ me kuptimin (arb. It., g.) "buzë lumi, breg deti", që e bën më se të besueshëm afrimin etimologjik dhe përqasjen formale me lat. *mons, -tis* "mal" (Vasmer 1921 39v, 61), çka mundëson rindërtimin e një forme bazë të përbashkët me shkallë ablautive zero të rrënjos: */myt-/. Shmangjet që vihen re në kuptimet e fjalës në shqipe dhe latinishte nuk janë aspak të pazakonshme, madje gjunjë mbështetje edhe në gjegjëse të ngjashme ndër gjuhët ballkanike, khs. shq. *mal* "mons, -tis" : rum. *mal* "breg lumi" (B. Demiraj 1997 67).

b) Në hyrje të zonës së Matit, bash në anën perëndimore të saj hasim një toponim që paraqet interes, pos të tjerash, edhe në zërthimin e marrëdhënieve gjuhësore-ethnike të gjithë krahinës në kapërcyell, në mos edhe përgjatë, periudhës së antikitetit. Bëhet fjalë këtu për toponimin e sotëm zyrtar *Pllana*, i cili ka konkurruar si i tillë variantet populllore të mëershme *P(ë)dhanë*, *B(ë)dhanë*, që konservojnë të pandryshuar ndërrimin dialektor /ð/ ~ /t/ (Gjinari 1989 174). Lidhur me historinë e këtij emërtimi janë dhënë deri sot dy mendime: a) i pari nga Norbert Jokl-i (1934 196) që niset prej variantit popullor

⁹ Ylli 2000 199.

¹⁰ Ylli 1997 298.

Pëdhänë, duke deduktuar këtu një toponim latin-roman të padëshmuar **Pedaneus* **“në këmbë/rrëzë të malësise”, i cili, sipas tij, duhet të jetë njojur dhe përdorur si i tillë prej popullsisë migratore shqipfolëse aty rrëth shekullit VIII e. j.¹¹, dhe b) i dyti nga albanologu i hershëm, por ende pak i njojur Ndre Mjeda (1935 241ff.), i cili arrin të izolojë këtu me saktësi ngulimin e hershëm ilir *Bassania* (Livius 44, 30), ndërkohë që vetë emërtimi gjellin sot e gjithë ditën në gojë të shqiptarëve në formën *P(ë)dhanë*, *B(ë)dhanë*.

Pa dashur të ndalem më gjatë në secilin argument, mund të përmend shkurt se bashkëlidhja që bën Mjeda midis toponimit ilir *Bassania* dhe emërtimit popullor *P(ë)dhanë*, *B(ë)dhanë* është bindëse në disa pamje, ndërsa vështirësia e përqasjes së segmenteve ilir. <-ss-> /s/ ~ shq. <dh> /ð/ (↓ <ll> /l/) kapërcehet lehtë, në rast se mbajmë parasysh zëvendësimet e ngjashme tingullore gjatë hyrjeve të të ashtuquajturave fjalë migratore / mesdhetare antike në fondin leksikor të shqipes, si p.sh.: shq. *thikë* : lat. *sica*; shq. *thes* : gr. vj. σάκ(κ)ος “thes (me lëkurë dhie)”, lat. *saccus* (< huazim nga semitishtja, khs. hebr. (fenik.) śaq “thes”); shq. *bathë* : gr. vj. φακός “thjerrë”, φάσηλος “lloj fasuleje” (> lat. *fasēlus*) etj.

4. Përfundim

Si përfundim mund të shtoj se hetimi i toponimit *Pëdhana*, pas gjase me burim ilir, përcjell një argument më shumë në përkrahje të tezës që vendbanimet e të parëve të shqiptarëve në periudhën e fundit të antikititet dhe fillimet e mesjetës duan kërkuar bash në hapësirën e sotme kompakte shqipfolëse. Gjithsesi ai (ri)hap edhe një problem, që nxit në një mënyrë a një tjetër hulumtimin *ndryshe* të periudhave të mëershme në zhvillimet e etnosit shqiptar, shi pozicionimin e tij në arealet kulturore-etnike të Ballkanit antik, të cilat jemi mësuar t'i quajmë sipas rastit si ilir, epirot, dardan, maqedonas etj. Le t'i japim më mirë një shans, duke njojur qoftë edhe si zgjidhje alternative gjallesën e tij si një entitet etnik-gjuhësor sa i veçantë aq edhe real në morinë e pseudopopujve të albanologjisë dhe të pseudogjuhëve të Ballkanit antik. Kështu edhe thënia e Pedersenit fiton më shumë kuptim.

¹¹ Ky kufizim në kohë bëhet për të motivuar mosrrëgjimin e mbylltores së zëshme /-d/ në pozicion ndërzanor që ka rrrokur pa përjashtim të gjitha huazimet e mirëfillta latine në shqipe.

Literaturë e përzgjedhur

Bartl, P.: Albanien. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart, Regensburg 1995.

Demiraj, B.: Sistemi i numërimit të gjuhës shqipe (vështrim diakronik), Tiranë 1997.

Demiraj, B.: Einheitlichkeit und Spaltung im Laufe des Christianisierungsprozesses der Albaner (Eine ethnolinguistische Fallstudie), në: „Studime“ 8-9 [2001-2002] 23-41, Prishtinë.

Demiraj, Sh.: The origin of the Albanians; linguistically investigated, Tiranë 2006.

Gjinari, J.: Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë 1989.

Jireček, K.: Valona im Mittelalter, në: „Illyrisch-albanische Forschungen“, bl. I, München u. Leipzig 1916 168-188.

Ködderitzsch, R.: Albanisch und Thrakisch, në: „Studia albanica“ [2001] 79-87.

Matzinger, J.: Kritische Kurzbemerkungen zur nordalbanischen Toponomastik: Die Namen der urbanen Zentren in adriatischen Küstenbereich, në: „Nordalbanien – L’Albania del Nord“ (botues M. Genesin & J. Matzinger), Hamburg 2009 87-101.

Mjeda, N.: Bassania, në: „Leka“ 7 [1935] 241-243, Shkodër.

Ölberg, H.: Die ursprünglichen Wohnsitze der Albaner auf der Balkanhalbinsel, në: „Dardania“ 4 [1995] 7-9, Wien.

Pedersen, H.: Die albanischen l-Laute, KZ 33 [1895] 535-551.

Schramm, G.: Eroberer und Eingesessene, Stuttgart 1981.

Schramm, G.: Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen, Freiburg/Br 1994.

Jokl, N.: Zur Ortsnamenkunde Albaniens, në: „Zeitschrift für Ortsnamenforschung“ 10 [1934] 181-206.

Stadtmüller, G.: Forschungen zur albanischen Frühgeschichte. Zweite erweiterte Auflage, Wiesbaden 1966.

Sufflay, M.: Das mittelalterliche Albanien, në: „Illyrisch-albanische Forschungen“ Bd. I, München u. Leipzig 1916 282-288.

Svane, G.: Die slawischen Lehnwörter im Albanischen, Aarhus Univ. Press, Aarhus 1992.

Vasmer, M.: Studien zur albanesischen Wortforschung I, Dorpat 1921.

Weigand, G.: Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder

- der Thraker, nö: „Balkan-Archiv“ 3 [1927] 227-251, Leipzig.
- Ylli, Xh.: Das slavische Lehngut im Albanischen, 1. Teil:
Lehnwörter, München 1997
- Ylli, Xh: Das slavische Lehngut im Albanischen, 2. Teil:
Ortsnamen, München 2000

SUMMARY

The author analyzes the main scientific theories debated during the second half of the XXth century by German-speaking linguists concerning the origins of Albanians vis-à-vis the territories inhabited by them.

The author considers the three main theses: the first considers Albanians to be natives of the northern Albanian region of Mati (thesis advanced by Georg Stadtmüller), next, the one that views Albanians as natives of the plains of northern Albania called Arbanon (hypothesis of Gottfried Schramm), where several thousand Thracian, followers of the Christian faith of the Besa tribe, had sought refuge having been forced to abandon their native lands in Remesiana around the year 820 A.D., and, finally, the third thesis that viewed Albanians as natives of the entire area where Albanian is spoken today (the Ölberg thesis).

Demiraj's approach rests on ethno-linguistic principles and his supporting rationale for considering Albanians as rooted in today's Albanian-speaking region are based on similar reasoning.